



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 3384 Prot.

Patos-më, 06/09/2024

Miratohet
Kryetari
Faton Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 63, datë 06.09.2024

**MBI MIRATIMIN E BLERJES SË MJETIT TEKNOLOGJIK PËR TRANSPORTIN
E MBETJEVE URBANE NË TË GJITHË TERITORIN, NGA FONDET ÇLIRUARA
NË PROGRAMIN "RRUGË RRURALE".**

Në zbatim të shkronjës dh neni 54, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 45, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 44, pika a, Vendimit të Keshillit Bashkiak nr. 81, date 18.12.2023 "Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2024", me miratim prefekturë nr. 1303/1 datë 03.01.2024, analiza dhe rishqyrtimi i projekteve për investime nga Drejtuesit e Programeve, kërkesës së Agjencisë së Shërbimeve Publike nr. 2061prot., dt. 01.08.2024, GMS pasi analizoj kërkesën, paraqet në Këshillin Bashkiak projekt vendimin , dhe

KËRKON:

1. Të miratojë blerjen e mjetit teknologjik për transportin e mbetjeve urbane në gjithë teritorin e Bashkisë, me vlerë 11,346,000 lekë.
Financimi i koston së këtij mjeti, do të bëhet nga fondi i çliruar nga prokurimi i objektit "Rikonstruks. Rrugës L.Re te Përroi Çam",.
2. Struktura buxhetore për këtë financim ndryshon si më poshtë:
 - Shtesë në programin **05100** "Menaxhimi i Mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit", Ilog.231 vlera 11,346,000 lekë.
Njësia shpenzuese ASHP 2112009
 - Paksim në programin **04520** "Rrugë Rurale", Ilog.231 vlera 11,346,000 lekë.
Njësia shpenzuese ASHP 2112001

Bashkëlidhur projekt vendimit, relacioni shoqërues.

EKIPET E MENAXHIMIT

Rrjeti rrugor Rural

Gazmira PLESATI

Silvana MICI

**Menaxhimi i mbetjeve
dhe mbrojtjes së mjedisit**

Eduart REFITAJ

Afërdita MUÇO

Marsilda **LIZAJ**



Juriste

Nurkë **HAZIZAJ**



Drejtues i Ekipit

Ermenita **MICI**



Alfred **GRËMI**



Valbona **SEMANJAKU**



Drejtues i Ekipit

Eneo **XHAFERI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 3384 Prot.

Patos më, 06/09/2024

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

MBI MIRATIMIN E BLERJES SË MJETIT TEKNOLOGJIK PËR TRANSPORTIN E MBETJEVE URBANE NË TË GJITHË TERITORIN, NGA FONDET ÇLIRUARA NË PROGRAMIN “RRUGË RRURALE”.

Shërbimi i pastrimit të qytetit të Patosit përbën një nga elementët më të rëndësishëm në detyrimet që bashkia e Patosit ka ndaj qytetarëve të saj dhe qytetit. Nisur nga kërkesat në rritje konstatohet se shërbimi i pastrimit të qytetit ka nevojë të rishikohet në funksion të përmirësimit të treguesve higjieno-sanitar dhe të përmirësimit të impaktit që ai ka në mjedisin e qytetit. Bashkia Patos në bashkëpunim me Agjencinë e Shërbimeve Publike po ndërmarrin masa të vazhdueshme në lidhje me pastrimin e qytetit dhe ofrimin e kushteve sa më të mira për komunitetin.

Me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të mirë është vlersuar si e domosdoshme blerja e një automjeti teknologjik i cili do të kryejë këtë proces në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët. Aktualisht bashkia disponon vetëm dy mjete të tilla që kryejnë këtë funksion, nga të cilët njëri nuk është funksional dhe automjeti tjetër është në kushtë jo të mira teknike dhe është i domosdoshëm për pastrimin e rreth 300 konteniervave të mbeturinave të shpërndarë në të gjithë territorin. Ky mjet, viti i prodhimit të cilit është 1991 është blerë nga bashkia Patos në vitin 2007 në vlerën prej 2,898,400 lekë. Aktualisht kostoja e amortizimit të këtij mjeti është e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit (2,898,400), duke u shoqëruar me efekte të tjera financiare si pasojë e përdorimit të tij prej shume vitesh. Këto efekte sjellin si rrjedhojë kosto të lartë mirëmbajtjeje, konsum më të lartë të karburantit në vlerën prej 9240 litër karburant në një vit. Po ashtu kostoja që mbulon riparimin e pjesëve teknike të mjetit ka një vlerë të konsiderueshme, si i vetmi mjet funksional që shërben për pastrimin e mbeturinave në të gjithë territorin.

Në këto kushte, qëllimi kryesor është mundësimi i shërbimit të pastrimit të qytetit në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët. Gjithashtu me blerjen e një mjeti të ri do të mundësohet pastrimi dhe transportimi i mbetjeve me intervale më të shpeshta duke përfshirë të gjitha tipet dhe llojet e koshave.

Financimi i kostos së blerjes së mjetit do të sigurohet nga fondet e çliruara nga prokurimi i objektit “Rikonstruksion i rrugës lagjja e Re, te përroi Çam”.
Mjeti do të përdoret nga Agjencia e Shërbimeve Publike, Patos.

DREJTUESI I EKIPIT
Rrugë Rurale

Ermenita **MICI**



DREJTUESI I EKIPIT
Menaxhim i mbetjeve dhe mbrojtjes
së mjedisit
Eneo **XHAFERI**



KRYETARI
Fation Duro

